



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS**

**MINISTRIA E PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT**

Nr. _____ Prot. Datë _____

Nr. _____ Prot. Datë _____

**SHTOJCË
NË DOKUMENTIN E POLITIKAVE
PËR
DECENTRALIZIMIN E SISTEMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVESRITAR NË SHQIPËRI**

Përgatitur nga :

**Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit**

Me asistencën e Bankës Botërore

Tiranë, Shtator 2004

I. HYRJE

Qeveria e Shqipërisë është në proces të reformimit të sistemit arsimor duke u përqëndruar në arsimin e detyrueshëm dhe atë të mesëm. Si pjesë e kësaj reforme, Qeveria është angazhuar për decentralizimin e funksioneve të arsimit në nivelin parauniversitar.

Një dokument politikash mbi decentralizimin e arsimit është firmosur nga MASH dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit më datë 31.05.2004. Ky dokument, u paraqit nga qeveria e Shqipërisë në Bankën Botërore në qershor 2004, për plotësimin e pjesës së PRSC II.

Pas analizës që ju bë dokumentit të politikave, Banka Botërore kërkoi që të përgatitej një plan i plotë me fazat dhe pilotimin e zbatimit të funksioneve të caktuara në nivele të ndryshme të qeverisë dhe në shkolla, siç përshkruhet në këtë dokument politikash.

II. PARIME UDHËHEQËSE

Në bazë të dokumentit të politikave të paraqitur nga qeveria e Shqipërisë, parimet udhëheqëse për planin e veprimit do të jepen në vijim. Siç vihet re, i gjithë personeli kyç i përfshirë në zbatimin e pilotimit do të bëjë trajnimin e kërkuar për përgjegjësitë e tyre të reja. Ky trajnim do të theksojë parimet e identifikuar këtu si dhe aftësitë e nevojshme për t'i konkretizuar këto parime.

1. Kërkesa për arritje të larta akademike, efikasitet administrativ dhe transparencë.

Plani pilot do të synojë arritje të larta akademike të nxënësve dhe efikasitet maksimal në kryerjen e shërbimeve, në bazë të standardeve të paracaktuara. Proçedurat e veprimit do të jenë të tilla që të kërkojnë transparencë maksimale.

2. Një “kulturë” e matjes

Të gjitha strukturat e përfshira në planin pilot, do të zhvillojnë dhe përdorin një sërë instrumentash për matjen dhe vlerësimin e rezultateve të pilotimit. Në mënyrë specifike, para fillimit të një faze të pilotimit, aktorët do të identifikojnë objektivat e tij, të dhëna, synime dhe standarte shërbimi, si dhe një numër shumë të kufizuar të treguesve të matshëm të këtyre objektiveve. Do të mblidhen të dhëna paraprake në mënyrë që pjesëmarrësit në pilotim të ndjekin progresin në kohë. Trajnimi i stafit do të përfshijë module mbi rëndësinë e qartësisë të synimeve të pilotimit dhe marrjes së komenteve objektive për suksesin e tij.

3. Menaxhimi mbi bazë të performancës.

Personeli që do të marrë pjesë në pilotim do të vlerësohet nga eprorët përkatës mbi bazën e performancës së secilit, sipas standardeve të caktuara. Këto standarde do të përcaktohen për çdo pozicion kyç që përfshihet në pilotim, duke filluar nga drejtorët e shkollave, personeli lokal e rajonal deri tek zyrtarët qëndrorë. Gjatë trajnimeve, zotëruesit e të gjitha posteve kyçe që do të marrin pjesë në pilotim do të mësojnë mbi standardet e performancës.

Ata do të trainohen që të veprojnë në bazë të standardeve të caktuara dhe të vlerësojnë të tjerët në bazë të performancës dhe rezultateve.

4. Roli i ri për drejtorët e shkollave

Drejtorëve të shkollave që marrin pjesë në pilotim, do t'u jepet përgjegjësia dhe kompetenca për të vlerësuar personelin e tyre mësimdhënës dhe administrativ, sipas standardeve të caktuara profesionale dhe akademike. Drejtorët e shkollave që do marrin pjesë në pilotim do të trajnohen për menaxhimin e personelit në shkollat e tyre, duke përfshirë të drejtën për të marrë në punë dhe për të pushuar nga puna si dhe për ngritjen në detyrë apo shpërblimin e mësuesve.

5. Metoda e Pjesëmarrjes

a. Zhvillimi i kurrikulave

Njësia qëndrore që merret me zhvillimin e kurrikulave, do të zhvillojë një mekanizëm konsultimi me mësuesit që marrin pjesë në pilotim rreth ndryshimeve në kurrikula. Mësuesit do të trainohen për të analizuar kurrikulën me qëllim që të identifikojnë ndryshimet të cilat do t'i bëjnë nxënësit të mësojnë më shumë.

b. Trainimi i mësuesve

Qendra Arsimore e Trainimit do të zhvillojë planifikimin e trajnimeve të mësuesve në shërbim me shkollat që bëjnë pjesë në pilotim. Ajo do të zhvillojë seminare të përbashkëta me mësuesë që marrin pjesë në pilotim në mënyrë sistematike.

c. Bordet e shkollave

Bordet e shkollave do të forcohen në të gjithë vendin. Do të kërkohet një përcaktim më i qartë i roleve në kushtet e kompetencave të decentralizuara. Anëtarët e bordeve të shkollave që marrin pjesë në pilotim do të trajnohen që të përmbushin përgjegjësitë e tyre të reja.

III. KOMPONENTËT E PILOTIMIT

Përpara se të nisë pilotimi do të ndërmerren disa masa paraprake, hapa të tjerë gjatë tij dhe të tjerë akoma në përfundim. Paragrafe të veçanta të këtij dokumenti përshkruajnë secilin nga këta hapa në mënyrë disi më të detajuar.

Para fillimit të Pilotimit

1. Të krijohet një grup pune në MASH për decentralizimin e arsimit me homologë në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrinë e Financave.
2. Të bëhet llogaritja e kostos dhe sigurimi i financimit për të zbatuar pilotimin
3. Të përzgjidhet një ekip konsulentësh teknikë të huaj dhe vendas që të mbështesë grupin e punës në MASH gjatë kryerjes (për aq kohë sa zgjat) së pilotimit.
4. Në bashkëpunim me komunat dhe bashkitë të marrin formë përfundimtare vendimet për sa i përket ndarjes së funksioneve në nivelet e ndryshme të qeverisjes.
5. Për çdo funksion, të përcaktohen standardet e shërbimit dhe një *numër i kufizuar* treguesish që mund të përdoren për të kontrolluar nëse sigurimi i shërbimit i plotëson këto standarde.
6. Të përzgjidhen njësitë vendore që do të marrin pjesë në çdo fazë të pilotimit, në bazë të kriterëve transparente të përzgjedhjes.
7. Të arrihet një konsensus mes të gjitha palëve në nivel qendror dhe lokal për të gjitha aspektet e programit të pilotimit.
8. Të përcaktohen kriteret për performancën dhe përshkrimet e punës për çdo pozicion të përfshirë në planin pilot në shkollë, institucionet vendore dhe qendrore dhe të caktohet personeli (listë emrash sipas pozicioneve) në këto poste.
9. Të caktohen bordet e shkollës dhe të përcaktohen rolet e tyre.
10. Të përcaktohen masat organizative dhe një kalendar për matjen e treguesve të sigurimit të shërbimit.
11. Duke përdorur treguesit e zgjedhur në hapin 5, të mblidhen të dhënat paraprake për njësitë vendore pjesëmarrëse në pilotim për funksione që janë decentralizuar apo do të decentralizohen në këto njësi.
12. Duke përdorur të dhënat paraprake, të arrihet një marrëveshje me autoritetet vendore dhe shkollat që marrin pjesë në pilotim për sa i përket një strukture rezultatesh për pilotimin, duke përfshirë synimet e performancës për çdo funksion nën juridiksionin lokal apo të shkollës.
13. Të përcaktohen kriteret e financimit dhe procedurave të financimit.
14. Të plotësohet legjislacioni dhe rregullat e kërkuara, përfshirë mekanizmin korrigjues.

Gjatë pilotimit

15. Të forcohen kapacitetet tek të gjithë pjesëmarrësit në pilotim me anë të planifikimit dhe realizimit të seminareve trajnuese.
16. Të organizohen seminare rregullisht me pjesëmarrës në pilotim që të vihen në dijeni paraprakisht për problemet që duhen zgjidhur. Duke përdorur këto informacione dhe të dhënat e performancës kur bëhen të disponueshme, të ridrejtohet pilotimi sipas nevojës.

Në përfundim të pilotimit

17. Të përdoren seminarët me pjesëmarrësit në pilotim dhe analizat e të dhënave të performancës për të vlerësuar rezultatet e pilotimit me qëllim shtrirjen e elementëve të decentralizimit në shkallë kombëtare.

IV. PËRSHKRIMI I ELEMENTËVE TË PILOTIMIT QË DUHEN PËRFUNDUAR PARA FILLIMIT TË PILOTIMIT.

IV.1. Krijimi i një Grupi pune të veçantë në MASH për decentralizimin e arsimit me homologë në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrinë e Financave.

Natyra dhe sfera e ndryshimeve të kërkuara në këtë përpjekje për decentralizim, kërkon një udhëheqje të fortë e plotësisht të përkushtuar nga ana profesionale dhe politike. Në MASH do të krijohet një njësi e veçantë në kuadër të zbatimit të projektit për decentralizimin. Kjo njësi do të financohet nga projekti dhe mendohet të përbëhet nga tre profesionistë si më poshtë:

- **Përgjegjësi i grupit për decentralizimin në sistemin arsimor**

Fushat e përgjegjësisë:

1. Drejtimi dhe menaxhimi i grupit në bashkëpunim me Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm në MASH.
2. Koordinimi me MPVD dhe MF, si dhe autoritetet vendore
3. Financimi
4. Monitorimi dhe Vlerësimi i procesit të decentralizimit si dhe koordinimi me asistencën teknike ndërkombëtare për këtë qëllim.

- **Specialisti i çështjeve administrative dhe ligjore**

Fushat e përgjegjësisë:

1. Investimet dhe mirëmbajtja

2. Transporti
3. Materialet
4. Burimet njerëzore
5. Ligjet dhe rregullat

- **Specialisti i çështjeve akademike**

Fushat e përgjegjësisë:

1. Koordinimi me Drejtorinë e Zhvillimit të Kurrikulave dhe IKS
2. Koordinimi me Qendrën e Trainimit të Mësuesve
3. Nxitja e vlerësimit të nxënësve
4. Nxitja dhe koordinimi i vlerësimit të punës së mësuesve
5. Koordinimi i aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve për të gjithë pjesmarrësit e planifikuar

IV.2. Llogaritja e kostos dhe sigurimi i fondeve për të zbatuar planin pilot.

Kostoja e hartimit dhe të realizimit të planit pilot (dhe përfundimisht shtrirja e tij në shkallë kombëtare) nuk do të jetë shumë e madhe, por sigurisht që do të kapërcejë fondet e disponueshme nga MASH. Që në fillimet e planifikimit të pilotimit, MASH duhet të bëjë llogaritjen e kostove vjetore të pilotimit dhe të sigurojë fonde për mbulimin e këtyre kostove.

Llogaritja e kostos duhet të përfshijë zëra si koston e njësisë së decentralizimit në MASH; nxjerrjen e manualeve të trajnimit dhe materialeve të studimit; seminare trajnimit për zyrtarë të nivelit vendor e qendror, drejtorët e shkollave dhe mësuesit kujdestarë, dhe anëtarët e bordeve të shkollave; pajisjet, si psh kompjutera dhe software; dhe një ekip konsulentësh teknikë vendas dhe të huaj në grupin e punës të decentralizimit në MASH.

IV.3. Përzgjedhja e një ekipi konsulentësh teknikë vendas dhe të huaj që do të mbështesë grupin e punës të decentralizimit në MASH gjatë gjithë kohëzgjatjes së pilotimit.

Grupi i punës të decentralizimit në MASH do të ketë nevojë për një ekip me konsulentë vendas dhe të huaj gjatë gjithë kohës së kryerjes së pilotimit që të këshillojë njësinë dhe drejtoritë e tjera për çështje teknike që dalin gjatë pilotimit. Përbërja e grupit konsulent duhet të ndryshojë në varësi të problemeve që kërkojnë zgjidhje në çdo kohë. Për shembull, përcaktimi i standarteve të shërbimit, treguesve të këtyre standarteve, strukturat e rezultateve dhe mekanizmave që të sigurojë matja e planifikuar e performancës do të kërkojë të paktën dy lloj ekspertësh që

të punojnë në grup: ekspertë në realizimin e shëbimit në sektorin e arsimit dhe në monitorimin e vlerësimit. Megjithatë, që të përcaktohen mekanizmat e financimit për decentralizim, kërkohen njohuri eksperte në financimin publik

Disa nga rolet që duhet të luajë ekipi i kononsulentëve vendas dhe të huaj, do të jenë:

- a. Të këshillojë dhe ndihmojë grupin e punës të decentralizimit në MASH në drejtimin e pilotimit
- b. Të këshillojë për standardet e shërbimit, treguesit e performancës, strukturat e rezultateve, si dhe grafikët kohor e mekanizmat e Monitorimit dhe Vlerësimit
- c. Të koordinojë dhe ndihmojë drejtorinë e decentralizimit në MASH që të udhëheqë monitorimin dhe vlerësimin e pilotimit.
- d. Të hartojë përshkrime pune të reja në bashkëpunim me MASH dhe aktorët në pilotim.
- e. Duke luajtur rolin e nxitësit, të ndihmojë në krijimin e marrëdhënieve konsensuale mes të gjitha palëve të interesuara
- f. Të bëjë koordinimin e standarteve të ndërtimit, mirëmbajtjes si edhe shërbimeve në bashkëpunim me MASH dhe palët e interesuara pjesmarrës në pilotim.
- g. Të nxisë ndryshimet në ligje dhe rregullore
- h. Të planifikojë forcimin e kapaciteteve tek të gjithë pjesmarrësit e planifikuar.
- i. Të përgatisë materiale udhëzuese për forcimin e kapaciteteve.
- j. Të trainojë trainuesit për forcimin e kapaciteteve tek të gjithë grupet pjesmarrëse.
- k. Të monitorojë forcimin e kapaciteteve që realizohet nga trajnuesi.
- l. Të këshillojë e udhëheqë grupin e punës të decentralizimit në MASH kur planifikon shtrirjen në shkallë kombëtare

IV.4. Në bashkëpunim me komunat dhe bashkitë, të finalizohen vendimet lidhur me ndarjen e funksioneve në nivelet e ndryshme të qeverisë.

Pushteti qendror në Shqipëri nuk ka pasur kohë të konsultohet gjerë e gjerë me autoritetet vendore, shkollat dhe bordet e shkollave për sa i përket ndarjes së funksioneve të propozuara në Dokumentin e Politikave për Decentralizimin ose në këto materiale shtojcë. Është shumë e rëndësishme që këto vendime provizore të diskutohen dhe të marrin formë të përfundimtare me aktorët përkatës në të gjitha nivelet e qeverisë dhe në shoqërinë civile.

Në finalizimin e ndarjes së funksioneve, aktorët duhet të ruajnë një dallim të qartë mes llojeve të modaliteteve të decentralizimit.¹

IV.5. Për çdo funksion, të përcaktohen standartet e shërbimit dhe një numër i kufizuar treguesish që mund të përdoren për të kontrolluar nëse sigurimi i shërbimit i plotëson këto standarte.

Ricaktimi i funksioneve nga pushteti qendror për atë vendor kërkon mbajtjen e përgjegjësisë (dhënien llogari) nga institucionet vendore para dy elektorateve të ndryshëm: Pushtetit Qendror nga njëra anë dhe qytetarëve lokalë nga ana tjetër.

Pushteti vendor do të jetë përgjegjës përpara Pushtetit Qendror

Pushteti vendor do t'i kryejë funksionet e sapocaktuara sipas një sërë standartesh të paracaktuara. Fillimisht, nga fundi i vitit të parë të këtij plani pilot, nga qeveritë vendore pritet që të arrijnë, minimalisht, të njëjtat rezultate me ato të arritura më parë nga pushteti qendror. Në fund të vitit të dytë të këtij plani, nga qeveritë vendore pritet që t'i përmirësojnë këto rezultate fillestare.

¹ Dekoncentrimi rishpërndan pushtetin e vendim-marrjes dhe përgjegjësive të menaxhimit dhe financës në nivele të ndryshme të pushtetit. Me anë të tij thjesht bëhet kalimi i përgjegjësive nga zyrtarë të pushtetit qendror në kryeqytet në ata të rajoneve dhe rretheve ose mund të krijohet një administrim i fortë në terren ose kapacitet admintrrimi lokal nën mbikqyrjen e ministrive të pushtetit qendror. Në këtë rast, këto struktura rajonale do të mbeten pjesë e strukturës administrative të Ministrisë së Arsimit, do të jenë nën mbikëqyrjen e plotë të MASH dhe Ministri do të jetë direkt përgjegjës para popullsisë lokale. Delegimi bën transferimin e kompetencave të caktuara specifike shtetërore tek autoritetet e vetëqeverisjes vendore sipas kushteve dhe standarteve të cilat janë caktuar nga pushteti qendror (MASH). Sipas ligjit nr. 8652/2000 këto transferime mund të jenë të detyrueshme ose vullnetare dhe mund të kryhen vetëm në bazë të ligjit dhe marrëveshjeve zyrtare mes autoriteteve të MASH dhe autoriteteve të pushtetit vendor. Këto transferime të përgjegjësive specifike duhet të financohen nga buxheti i shtetit. Në rastin e përgjegjësive të deleguara autoritetet e vetëqeverisjes vendore do të veprojnë si "agjentë" të MASH autoritetet e vetëqeverisjes vendore do t'i raportojë MASH, dhe kjo e fundit do të mbetet përgjegjës përpara qytetarëve. Kalimi i Kompetencave/decentralizimi transferon pushtetin e vendim-marrjes për përgjegjësi/kompetenca të specifikuar qartë tek autoritetet e vetëqeverisjes vendore. Në këtë rast, autoritetet e vetëqeverisjes vendore (Këshillat vendorë dhe Kryetarët e Komunave) janë autonom në vendosjen e prioriteteve (nga burimet e buxhetit lokal, duke përfshirë taksat e ndara dhe lokale, tarifat si dhe transferimet e kushtëzuara nga qendra) dhe janë plotësisht dhe drejtpërdrejt përgjegjës ndaj qytetarëve/ zgedhësve.

Pushteti vendor do të mbajë përgjegjësi përpara qytetarëve

Zakonisht shërbimet qeveritare hartohen duke ndjekur metodën “nga brenda-jashtë”, ato pasqyrojnë struktura dhe procedura, kryesisht të konceptuara nga perspektiva e brendshme e siguruesit të shërbimit e jo si një plotësim i nevojave të qytetarëve. Vendosja dhe zbatimi i standarteve të shërbimeve përdoret si instrument që të plotësojë kërkesat e qytetarëve me shërbimet e ofruara nga institucionet e pushtetit vendor si edhe qendror. Standartet e shërbimeve zakonisht bazohen në një perspektivë “nga jashtë-brenda”, ku nevojat dhe shpresat/ajo çka presin qytetarët konsiderohen si parime përcaktuese të shërbimit. Kënaqësia në rritje e qytetarëve është një nga parametrat kryesorë matës të suksesit.

Disa shembuj të standarteve janë:

- Mësuesit do të kenë të paktën tre biseda personale me prindërit e çdo fëmije gjatë vitit shkollor.
- Drejtorja e Kurrikulës do të organizojë konferenca me mësues të secilës lëndë mbi bazë rajoni të paktën një herë në vit.
- Qytetari do të informohet qartë mbi të gjitha hapat që duhen ndërmarrë në çdo procedurë.
- Një raport financiar i shkollës do të botohet dy herë në vit.
- Arritjet e nxënësve dhe ecuria e shkollës do të bëhen publike një herë në vit.
- Ndërtime të reja shkollash në bashkitë e mëdha duhet të planifikohen në mënyrë që të ketë jo më pak se 35 nxënës për klasë.
- Tavolinat e nxënësve do të jenë të përmasave të miratuara për klasat nga e para tek e treta, karriget do të kenë një lartësi Y cm, për klasën e katërt deri në të gjashtë do të kenë lartësi Z cm.
- Në çdo shkollë do të vrojtohet se sa të kënaqur janë prindërit të paktën një herë në vit.
- Plane për ndërtimin e shkollave dhe projekte për pajisjen e mobilimit të tyre do të paraqiten në komunitet për aprovim dy muaj para autorizimit të tyre zyrtar.

Disa shembuj të rezultateve të pritshme në funksionet e një sistemi arsimor të decentralizuar në nivel lokal mund të jenë:

- Në vitin e parë. Niveli i nxënësve të rregjistruar do të jetë i njëjtë si në kohën kur funksionet i përkisnin nivelit qendror. Në vitin e dytë, nën përgjigjësinë e pushtetit lokal, rregjistrimet e nxënësve do të rriten me 8% kurse në vitin e tretë 12-15% në krahasim me vitin e parë.
- Numri i mësuesve që marrin pjesë në procesin e zhvillimit të kurrikulës do të rritet me 10% çdo vit për pesë vitet në vazhdim.

- Arritjet e nxënësve në nivel lokal në provimet kombëtare do të rriten me 10% në vit.
- Numri i mësuesve që ndjekin trainimet në shërbim do të rritet deri në 25% në dy vitet e para të zbatimit të plotë të strukturës organizative.
- Të paktën 10% e prindërve do të rrisin përfshirjen e tyre në sistemin arsimor në vitin e parë të zbatimit të strukturës së decentralizimit. Në vitin tjetër përqindja do të rritet deri në 20%; dhe në vitin e tretë në 40%.
- Në vitin e parë të decentralizimit, 20% e prindërve do të tregojnë një rritje në shkallën e kënaqjes së tyre me performancën e sistemit arsimor; në vitin e dytë 35% dhe në të tretin më shumë se 50%.

IV.6. Përzgjedhja e njësive vendore që do të marrin pjesë në çdo fazë të pilotimit në bazë të kriterëve transparente.

Pas konsultimeve më palët e përfshira në decentralizim, do të përcaktohen kriteret për përzgjedhjen e grupeve që do të marrin pjesë në pilotim dhe këto do të *publikohet gjerësisht për të treguar të gjithëve se ato janë transparente*. Kriteret e mundshme të përzgjedhjes përfshijnë: madhësinë e komunitetit, llojet e shkollave (ndonjë shkollë profesionale etj.), llojin e njësisë së pushtetit vendor (bashkia kundrejt komunës), rajoni, komuna, shpërndarja e të ardhurave të popullsisë, shpërndarja arsimore e popullsisë, dinamika e popullsisë (popullsi në pakësim apo në shtim), dëshira për të marrë pjesë në pilotim (të shikohen që në hapat e para të pilotimit)

IV.7. Arritja e një konsensusi mes të gjitha palëve në nivel qendror dhe lokal për të gjitha aspektet e programit të pilotimit.

MASH dhe MPVD do të krijojnë një frymë konsensusi me të gjitha palët që marrin pjesë në programin pilot në aspektet e mëposhtme:

- a. Ndarja e re e funksioneve
- b. Skemat e përgjegjësive, autoriteteve dhe përgjegjshmërisë (sipas emrave dhe posteve),
- c. Mekanizmat e financimit
- d. Mekanizmat e korrigjimit
- e. Monitorimi dhe vlerësimi
- f. Pjesëmarrja në aktivitetet për forcimin e kapaciteteve

IV.8. Përcaktimi i kriterëve të performancës dhe përshkrimeve të punës për çdo pozicion të përfshirë në pilotimin në shkollë si dhe në institucionet në nivel qendror dhe vendor dhe caktimi i një personeli në këto poste

Në bashkëpunim me shkollat dhe qeverinë lokale, grupi i punës në MASH do të: a) identifikojë llojet e pozicioneve që kërkohen nga çdo njësi vendore që do të marrë pjesë në pilotim për të përmbushur përgjegjësitë e saj në pilotim, b) të hartohet një përshkrim pune për çdo pozicion; dhe c) të bihet dakord mbi kriteret e performancës për çdo lloj pozicioni.

Në konsultim me shkollat dhe pushtetin vendor si dhe me MPVD, MASH do të përgatisë listën e mëposhtme të pjesëmarrësve në pilotim në të dyja nivelet -kombëtar dhe vendor:

- Zyrtarët vendorë të cilët do të marrin funksione të reja
- Ekipet drejtuese të shkollave
- Mësues nga shkollat
- Anëtarë nga bordet e shkollave në komunitetet e përfshira në pilotim
- Inspektorë
- Zyrtarë nga Qendra e Trainimit të Mësuesve
- Zyrtarë nga Drejtoria për Zhvillimin e Kurrikulave

IV.9. Caktimi i Bordeve të Shkollës dhe përcaktimi i roleve të tyre sipas decentralizimit.

Bordet e Shkollave do të forcohen në të gjitha njësitë vendore që marrin pjesë në pilotim. Bordet do të kenë këtë përbërje:

- Numri në total i anëtarëve: 11
- Përbërja: 5 prindër, 2 mësues, 2 nxënës (nga klasat 5-8), 1 përfaqësues lokal, 1 sponsor apo anëtar komuniteti me reputacion të mirë.

Një sërë rregullash dhe procedurash do të vendosen për funksionimin e Bordeve të Shkollave në fillim të programit Pilot. Kjo do të kërkojë modifikimin e kuadrit ligjor aktual mbi bordet e shkollave siç jepet më poshtë. Për shembull pika 8 flet mbi një takim tremujor të Bordit. Në bazë të decentralizimit kjo mbase duhet të ndryshohet në takim mujor.

1. Bordi i shkollës është një institucion që përfaqëson interesat e komunitetit ku ndodhet shkolla dhe funksionon si një organ vendimmarrës për të kontribuar në mënyrë konstruktive për një qeverisje demokratike të problemeve administrative dhe financiare të shkollës si dhe menaxhimin e saj.

2. Bordi i shkollës ngrihet me bazë shkollën[I]në raste të vecanta , (ref. në shkollat e fshatrave të vegjël), ai ngrihet mbi bazë 2-3 komunash. Për shkollat që nuk i plotësojnë kushtet... në bazë komunash, nuk ka bord.
3. Pushteti/e drejta dhe procedurat e krijimit të bordit i takojnë dhe zbatohen nga drejtori i shkollës i cili brenda 10 ditëve nga krijimi i tij, njofton me shkrim drejtorinë arsimore dhe pushtetin vendor. Kur bordi ngrihet në bazë komune (duke mbuluar 2-3 shkolla të vogla), iniciativa merret nga drejtori i shkollës që ka numrin më të madh të mësuesve. Në këto raste, bordi quhet “Bordi i Shkollave” dhe drejtorët e të gjithë shkollave bëhen anëtarë.
4. Numri i anëtarëve të bordit duhet të jetë gjithmonë tek. Në çdo procedurë të zgjedhjes së anëtarëve të bordit drejtori i shkollës është i pranishëm dhe paraqet propozimet sipas rastit.
5. Kryetari i Bordit të shkollës zgjidhet nga votat e përfaqësuesve të prindërve.
6. Drejtori i shkollës, i cili është anëtar bordi, mban në të njëjtën kohë edhe pozicionin e sekretarit. Në rastet kur bordi i shkollave është mbi bazë komunash, drejtorët e shkollave të cilët janë anëtarë bordi, janë njëkohësisht sekretarët e tij, secili për shkollën e tij.
7. Përfaqësuesit e prindërve në bord zgjidhen çdo 2 vjet kurse anëtarët e tjerë çdo vit, por gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.
8. Si rregull, bordi i shkollës (shkollave) mblidhet çdo tremujor për të analizuar aktivitetin e tij. Mund të mblidhet sa herë të shihet e arsyeshme me propozim të kryetarit ose të sekretarëve.
9. Bordi i shkollës (shkollave) merr vendime me miratimin e 2/3 të anëtarëve të tij.
10. Aktiviteti i bordit të shkollës (shkollave) dhe vendimet që ai merr, janë të gjitha të paraqitura në një dokument të vecantë i quajtur “ Protokolli i aktivitetit të Bordit të Shkollës (shkollave).”

IV.10. Krijimi i mjeteve organizative dhe një kalendar për matjen e sigurimit të shërbimeve nëpërmjet treguesve.

Ndonëse grupi i punës të decentralizimit në MASH kryen një mbikëqyrje të Monitorimit dhe Vlerësimit, Njësia e Planifikimit dhe Analizave në MASH dhe pushteti lokal së bashku me shkollat që marrin pjesë në

pilotim duhet të jenë aktorë qëndror në kuadrin organizativ për monitorimin dhe vlerësimin. Mekanizmat për organizimin e monitorimit dhe vlerësimin, më shpesh kanë dështuar se nuk kanë pasur sukses dhe asistencë teknike për grupin e punës të decentralizimit. MASH duhet të jetë shumë e angazhuar me përgatitjen organizative, forcimin e kapaciteteve dhe mbikëqyrjen. Mbledhja e të dhënave aktuale (hapi 11) krijon mundësinë për të parë se sa mirë funksionon mekanizmi.

Është i nevojshëm përgatitja e një kalendari për të regjistruar rezultatet në mënyrë periodike.

IV.11. Duke përdorur treguesit e përzgjedhur në hapin 5, mblidhen të dhëna për njësitë vendore që do të marrin pjesë në pilotim për funksionet që janë decentralizuar apo do të decentralizohen në këto njësi vendore.

Duke përdorur mekanizmin e monitorimit dhe vlerësimin të paracaktuar në hapin 10, mblidhen të dhëna mbi treguesit e shpërndarjes së shërbimeve.

IV.12. Duke përdorur të dhënat e mbledhura, bihet dakord me pushtetin vendor dhe shkollat që marrin pjesë në pilotim mbi rezultatet për pilotimin, duke përfshirë objektivat e performancës për çdo funksion nën juridiksionin vendor apo të shkollës.

Hapi mbi arritjen e marrëveshjes mbi rezultatet për pilotimin është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të gjithë aktorët të mund të kuptojnë plotësisht objektivat e tyre dhe të shohin progresin apo mos-plotësimin e tyre. Në fund, sukcesi apo dështimi i dimensioneve të ndryshme të pilotimit do të gjykohet relativisht në bazë të këtyre rezultateve.

IV.13. Përcaktimi i kriterëve dhe procedurës së financimit.

Ndarja e funksioneve duhet të mbështetet nga kriteret dhe procedura financimi në përputhje me ndarjen e tyre.

Kriteret për financim duhet të marrin në konsideratë:

- a. *Funksionet e deleguara në nivelet vendore të cilat mund të identifikohe si të veçanta në buxhetin e shtetit për arsimin:* Fondet do të transferohen nga buxheti aktual në agjensitë e pilotimit në mënyrë të përpjestueshme, sipas faktorëve të aplikueshëm si: madhësia e komunitetit, numri i shkollave, largësia mes shkollave, madhësia e shkollave etj.

- b. *Funksionet e rialokuara të cilat nuk mund të identifikohen në mënyrë të veçantë nga buxheti i shtetit për arsimin, do të planifikohen në mënyrë të detajuar në bazë të një përlllogaritjeje të plotë të shpenzimeve reale për të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren për të kryer këto funksione.*
- c. Sigurimin e *barazisë* mes të gjitha njësive që do të pilotohen në aplikimin e variantit a dhe b.
- d. Përgjegjshmërinë: të prezantuar në një raport të veçantë për MASH, MF dhe MPVD mbi menaxhimin e këtyre fondeve që do të kërkohet nga çdo institucion vendor që pilotohet.

Procedurat e financimit do të qartësohen më tej në të ardhmen

IV.14. Plotësimi i legjislacionit dhe rregullave të kërkuara.

Pilotimi do të kërkojë ndryshime në aktet ligjore përkatëse që duhet të miratohen nga qeveria dhe parlamenti si hap i parë drejt zbatimit në shkallë kombëtare të decentralizimit. Kështu, para se të zbatohet plani i pilotimit, një këshilltar ligjor në MASH do të përcaktojë kërkesat ligjore që duhen për realizimin e tij dhe do të hartojë ligjet dhe rregullat e nevojshme. Ministritë e përfshira do të kërkojnë miratimin e tyre.

Disa nga ligjet dhe rregullat lidhen me:

- a. Akordimin e fondeve
- b. Transferimin e fondeve
- c. Investimet dhe mirëmbajtjen
- d. Mekanizmat e korrigjimit
- e. Standartet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes
- f. Procedurat e prokurimit
- g. Autoritetin e ri të drejtorit të shkollës
- h. Bordet e shkollave, rolet dhe autoritetet/kompetencat e tyre
- i. Përcaktimin e pagave
- j. Shpërblimet për punë me cilësi të lartë

Kuadri ligjor dhe rregullat kërkohet të përfshijnë mekanizmat e korrigjimit çdo rast të performancës së dobët nga strukturat vendore. Një strategji e mundëshme korrigjimi do të jetë si më poshtë:

- a. Fillimisht, një vlerësim i përmbledhur do të informojë të gjithë pjesëmarrësit mbi nevojën për përmirësimin e performancës, dhe është përgjegjësia e të dyja palëve, strukturave vendore dhe qëndrore, për të ofruar këshillë dhe udhëzime sipas nevojës për të përmirësuar shkallën e performancës.
- b. Së dyti, në rastet ku raportet përmbledhëse nuk tregojnë rezultate pozitive, strukturave lokale do t'u ofrohet një paketë e veçantë

- asistence, duke përfshirë trainime për përmirësimin e përformancës.
- c. Nëse hapat e mësipërme dështojnë, funksionet do t'i kalojnë nën përgjegjësi nivelit vijues më të lartë të qeverisjes.
 - d. Niveli më i lartë mund të mendojë pas një periudhe jo më pak se 12 muaj, që kushtet e rrethanat penguese kanë ndryshuar. Në këtë rast, funksionet me skemat korresponduese të pushtetit, përgjegjësitë, si dhe mekanizmat e financimit mund të rivendosen në nivel vendor.
 - e. Ky nivel administrimi do të vlerësohet në bazë të hapave të lartë përmendur deri në nivelin qëndror të qeverisë.

Gjatë pilotimit

IV.15. Forcimi i kapaciteteve për të gjithë aktorët që do të marrin pjesë në pilotim me anë të planifikimit dhe realizimit të seminareve trajnuese.

Plani pilot do të shoqërohet nga një program intensiv për forcimin e kapaciteteve. Popullsia që do të marrë pjesë në pilotim dhe do të trajnohet me anë të një programi trajnimi që do të funksionojë për:

- a. Drejtorët dhe vendimarrësit e shkollave
- b. Bordet e shkollave
- c. Zyrtarët vendor
- d. Inspektorët
- e. Personelin e mirëmbajtjes dhe riparimeve
- f. Sektorët e Trajnimit të Mësuesve
- g. Institutin e Kurrikulave dhe Standardeve
- h. Mësuesët e zgjedhur

Zyrtarët e MASH në nivel lokal dhe qëndror që do të kenë pozicione kyçe në lidhje me planin e pilotimit do të trainohen gjithashtu me grupet e sipërpërmendura.

Numri total i pjesëmarrësve në këto aktivitete do të jetë si më poshtë: deri në 25 zyrtarë të pushtetit qendror; deri në 100 zyrtarë të pushtetit vendor; deri në 150 drejtorë shkollash; deri në 300 mësues kujdestarë dhe deri në 300 prindër. Seancat e trajnimit do të zgjasin 5 ditë për çdo seminar. Çdo grup do të ketë deri në 25 pjesëmarrës.

Do të zhvillohen deri në 40 seminare: 1 seminar për zyrtarët e qeverisë; 1 seminar për zyrtarë të pushtetit qendror; 5 seminare për zyrtarë të pushtetit vendor; 20 seminare për drejtorë shkollash dhe ekipe drejtuese të shkollave; dhe 12 seminare për përfaqësues të Bordeve të Shkollave (prindër).

IV.16. Organizimi i seminareve të rregullta me pjesëmarrësit në pilotim për të marrë një njoftim paraprak mbi problemet që duhet të zgjidhen.

Arsyeja për organizimin e këtij pilotimi është të mësohet se çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon. Grupi i punës të decentralizimit në MASH duhet të organizojë seminare të rregullta me të gjithë aktorët e përfshirë në nivele qendror, lokal, shkolla dhe komunitete mbi problemet që duhen zgjidhur.

Ky informacion nga komentet dhe të dhënat mbi performancën, duhet përdorur për t'i dhënë drejtimin e duhur pilotimit.

Në përfundim të pilotimit

IV.17. Do të shfrytëzohen seminarët me pjesëmarrësit në pilotim dhe analizat e performancës për të vlerësuar rezultatet dhe identifikuar mësimet e nxjerra nga pilotimi të cilat mund të përdoren më vonë në shtrirjen e pilotimit në shkallë vendi.

Kur pilotimi i afrohet përfundimit, është shumë e rëndësishme që të vlerësohet i gjithë informacioni i disponueshëm mbi mënyrën se si do të shtrihet ai në shkallë vendi. Nëse kjo nuk do të bëhet, vetë pilotimi nuk do të kishte kuptim.

V. Fazat

Siç thuhet edhe në letrën e politikave, decentralizimi do të kryhet nëpërmjet tre fazash pilotimi. Këto faza do të kenë tre karakteristika kryesore. Së pari, do të pilotohen grupe të ndryshme funksionesh në çdo fazë. Së dyti, alokimi i funksioneve në faza duhet të jetë koherent nga pikëpamja funksionale brenda çdo faze dhe ndërmjet fazash. Së treti, çdo fazë pilotimi duhet të shtrihet në shkallë kombëtare, duke marrë në konsideratë mësimet e nxjerra gjatë pilotimit. Tabela më poshtë me afate kohore të menduara paraqet këtë koncept: pilotim/shtrirjes, pilotim/shtrirje.

Phases	Start	2005	2006	July/2007	Beyond 2008
I Pilot					
I National Expansion					
II Pilot					
II National Expansion					
III Pilot					
III National Expansion					

MATRICA E ALOKIMIT TË FUNKSIONEVE

FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
1. Personeli mësimdhënës (drejtorët e shkollave dhe mësuesit)			
1.2 Trajnimi			
Planifikimi i trajnimit të mësueve në shërbim	Qëndror/ dekoncentruar	Nivel shkolle Drejtori do të mbledhë kërkesat nga mësuesit e tij të cilat do të paraqiten në Drejtorinë Rajonale	Drejtoria Arsimore Rajonale Mbledh kërkesat nga shkollat, jep informacion tek Instituti i Kurrikulave, dhe koordinon shpërndarjen Qëndror: MASH, QKAVP, IKS, QAT Instituti i Kurrikulave dhe QAT ofron trajnime në shërbim. (me metodën lart-poshtë) Mbledh kërkesa nga Drejtoritë Rajonale. Planifikon dhe shpërndan trajnimet (me metodën nga poshtë-lart))
Trajnimi i mësuesve në punë	Qëndror/ dekoncentruar	I paaplikueshëm	Niveli Rajonal Koordinon vlerësimin e trajnimit në punë me Institutin e Kurrikulave dhe QAT. Instituti i Kurrikulave dhe QAT shpërndan trajnimin në punë dhe vlerëson në koordinim me nivelin rajonal

FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
1.3 Ngarkesa e mësimdhënies dhe detyrat	Qëndror/ dekoncentruar		
Përcaktimi i numrit të stafit që nevojitet për çdo institucion/ vit /funktion	Qëndror/ dekoncentruar	Këshillat e komunave dhe bashkive Autorizojnë kërkesat e shkollës në përputhje me standardet e paracaktuara Nivel shkolle Drejtori i shkollës i kalon këshillit të komunës/bashkisë kërkesat mbi personelin	Qëndror: MASH Përcakton standardet për personelin
Përshkrimet e punës	Qëndror/ dekoncentruar	Nivel shkolle Drejtori vlerëson punën e mësuesve, merr në punë dhe pushon nga puna sipas standardeve të paracaktuara të performancës	Qëndror: MASH përcakton përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet në shkolla në bashkëpunim me Pushtetin Vendor. Përcakton standardet e performancës
Struktura e punësimit (ngarkesë e pjesëshme ose e plotë)	Qëndror/ dekoncentruar	Nivel shkolle Drejtori i shkollës do t'i bëjë këshillit vendor rekomandime mbi punësimin e mësuesve me kohë të plotë ose të pjesëshme sipas standardeve të paracaktuara. Këshilli i bashkisë/komunës Autorizon dhe i kalon Drejtorisë Rajonale, punësimin me kohë të plotë dhe të pjesëshme të personelit mësimor duke ndjekur normat dhe standartet e para caktuara nga pushteti qendror. Ky seksion do të rikonsiderohet më vonë.	Qëndror: MASH Përcakton standardet dhe rregulloren Drejtoria Arsimore Rajonale Kontrollon përputhjen me normat dhe standardet e Këshillat e Bashkive/Komunave. Ju jep këshillave të bashkive/komunave autorizimin final mbi punësimin dhe pushimin e personelit mësimor.

FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
1.4 Vlerësimi			
Mbikëqyrja	Vendor/ Qendror	Këshilli i Bashkisë/Komunës Mbikqyr administrimin e shkolles ne drejtim të shërbimit dhe mirëmbajtjes materiale, , komunikimin me komunitetin, frekuentimin e nxenesve, respektimin e detyrimeve për disiplinën në punë.	Qëndror: MASH, DAR, ZA,
Vlerësimi performancës	Qendror/ Vendor	Nivel shkolle Drejtori i Shkollës vlerëson performancën e mësuesve në bazë të standardeve të paracaktuara dhe i bën rekomandime Këshillit të Komunës/bashkisë për rastet e marrjes në punë dhe pushimit nga puna të mësuesve Bordet e shkollës dhe Këshillat e Bashkive/komunave Vlerësojnë performancën e drejtorit të shkollës sipas standardeve të paracaktuara në koordinim me Drejtoritë Arsimore Rajonale. Ky seksion do të diskutohet më vonë	MASH Vendos standartet e performancës për mësuesit dhe drejtorët. Drejtoria arsimore rajonale Kontrollon performancën e mësuesve dhe drejtorëve. Autorizon punësimin dhe pushimin nga puna duke marrë parasysh rekomandimet e bordeve të shkollave dhe këshillave të bashkive/komunave Ky seksion do të diskutohet më vonë
2. Staf i jo mesimdhënës (personeli i shërbimeve duke përfshirë edhe ata që punojnë në konvikte)			
Standardet	Vendor	(Nivel shkolle Drejtori i shkollës do të ketë përgjegjësinë për përcaktimin e standardeve që do të autorizohen nga drejtoria rajonale	Drejtoria Arsimore Rajonale Autorizon Standardet
Punësimi dhe pushimi	Vendor	Nivel shkolle Puneson dhe pushon nga puna sipas nevojës dhe strukturave të miratuara nga drejtoritë rajonale, punonjes shërbimi dhe mirëmbajtje, kujdestar konviktesh, roje etj.	Drejtoria Arsimore Rajonale Autorizon skemat e strukturave/organizimeve
Financimi (përveç konvikteve për arsimin bazë)	Vendor	Këshillat e bashkive/komunave Përdor burime nga transfertat e buxhetit të shtetit si dhe të ardhurat vendore, nga	MASH, MPVD dhe MF Akordojnë dhe transferojnë fonde tek bashkitë dhe komunat në bazë

		pagesat e nxenesve.Nxit dhe përdor fondet nga donatore te ndryshem.	të kritereve të paracaktuara
Financimi për pjesë të arsimit të detyrueshëm	Qëndror/ dekoncentruar	Këshillat e bashkive/komunave Përdorin burime nga transfertat e buxhetit të shtetit si dhe të ardhurat vendore nga pagesat e nxenesve. Nxisin dhe përdorin fondet nga donatorë të ndryshëm.	MASH, MPVD dhe MF Akordojnë dhe transferojnë fonde tek bashkitë dhe komunat në bazë të kritereve të paracaktuara Qëndror:njësi e dekoncentruar
3. Programet lëndore dhe kurrikula			
Përcaktimi i programeve lëndore	Qëndror/ Shkollë/Vendor	Nivel shkollë Drejtorët e shkollave do të jenë përgjegjës për mbledhjen dhe transmetimin e opinionëve dhe mendimeve mbi programet lëndore të sygjera nga Instituti i Kurrikulave. Ky material do të mblidhet nga reagimet e mësuesve dhe nxënësve ndaj strukturave konceptuale si dhe materialeve didaktike. Për rishikimin e programeve lëndore	Instituti i Kurrikulave Përgatit dhe rishikon programin lëndor në koordinim me Drejtoritë Rajonale e cila Mbledh opinionin e shkollave dhe e kalon atë tek Instituti i Kurrikulave
Zhvillimi i kurrikulave	Qëndror/ Vendor	Nivel shkollë Drejtorët e shkollave do të jenë përgjegjës për mbledhjen dhe transmetimin e opinionëve dhe mendimeve mbi programet lëndore të sygjera nga Instituti i Kurrikulave. Ky material do të mblidhet nga reagimet e mësuesve dhe nxënësve ndaj strukturave konceptuale si dhe materialeve didaktike.	Instituti i Kurrikulave Përgatit dhe rishikon programin lëndor në koordinim me Drejtoritë Rajonale Nivel Rajonal Mbledh opinionin e shkollave dhe e kalon atë tek Instituti i Kurrikulave për rishikim e kurrikulës.
Përcaktimi i lidhjeve vertikale dhe horizontale sipas skemës: Lëndë/klasa/moshë,	Qëndror/ Shkollë/Vendor	Nivel shkollë Drejtorët e shkollave do të jenë përgjegjës për mbledhjen dhe transmetimin e opinionëve dhe mendimeve mbi programet lëndore të sygjera nga Instituti i Kurrikulave. Ky material do të mblidhet nga reagimet e mësuesve dhe nxënësve ndaj strukturave konceptuale si dhe materialeve didaktike.	Instituti i Kurrikulave Përgatit dhe rishikon lidhjet vertikale dhe horizontale në koordinim me Drejtoritë Arsimore Rajonale të cilat Mbledhin opinionin e shkollave dhe e kalon atë tek Instituti i Kurrikulave për rishikim
4. Testimi			
Përcaktimi i standardeve të përmbajtjes dhe arritjes	Qëndror	Nivel shkollë Shkolla të përzgjedhura nga drejtoritë rajonale marrin pjesë në konsultime me QKAVP	QKAVP përgatit standarte akademike në nivel kombëtar në konsultim me drejtoritë rajonale, Institutin e Kurrikulave dhe Drejtorinë e Zhvillimit të Kurrikulave në MASH

			Drejtoritë Arsimore Rajonale Merr pjesë në konusultime me QKAVP për vendosjen e standardeve akademike
Vlerësimi i arritjeve të nxënësve	Qëndror/ dekoncentruar	Nivel shkolle- Aplikon testimet dhe jep rezultatet ne nivel rajonal. Niveli rajonal Konsideron rezultatet si të dhëna për vlerësimin e shkollave.	QKAVP analizon rezultatet dhe rishikon standardet e paravendosura në bashkë-punim me Inst.Kurrikulave
FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
Vlerësimi i arritjeve të Institucionit	Vendor / Qendror	Nivel shkolle Drejtori i shkollës mbledh informacion mbi performancën e mësuesit dhe nxënësit në bazë të instrumentave të vlerësimit të përcaktuar nga drejtoria rajonale, EMIS dhe QKAVP	QKAVP Harton standardet për performancën institucionale, realizon studime krahasuese në shkallë kombëtare, jep informacion tek agjensitë e tjera të përfshira si psh. Institutin e Kurrikulave, Qendrën e Arsimore të Trajnimit të Mësuesve etj. Drejtoritë Arsimore Rajonale Mblidhet informacion mbi performancën institucionale, bëhet krahasimi mes shkollave të ndryshme të të njëjtit rajon, jepet informacioni në pushtetin qendror.
5. Informatizimi i sistemit arsimor			
Grumbullimi i të dhënave	Vendor / Qendror	Nivel shkolle Mblidhet dhe sigurohet informacioni i kërkuar mbi performancën e shkollës duke plotësuar formularët e caktuar. Këshillat e komunave/bashkive Mblidhet informacion krahasues mbi shkolla të së njëjtës komunë/bashki. Aplikon masat për përmirësim kur është e nevojshme.	Drejtoria e Informacionit dhe Statistikës në MASH dhe QKAVP Mbledhin të dhënat nga drejtoritë rajonale Drejtoritë Arsimore Rajonale Mbledh informacion nga të gjithë drejtorët e shkollave mbi performancën e shkollave në rajon

FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
Analiza e të dhënave	Qendror	I paaplikueshëm	QKAVP Analizon informacioni në nivel rajonal dhe kombëtar. Kryen krahasime, dhe transmeton rezultatet e analizuara tek vendim marrësit në nivele qendrore dhe vendore (Drejtoritë Rajonale, Këshillat, drejtorët)
Hartimi i raportve të vlerësimit	Qendror/ Vendor	Këshilli i Bashkisë/komunës Informohet mbi rezultatet nga drejtoritë rajonale. Autorizon aplikimin e masave për planet e përmirësimit dhe masat specifike.	QKAVP në bashkëpunim me ISK dhe QAT Përgatit raporte vlerësimi dhe i vë ato në dispozicion të publikut. Drejtoritë Arsimore Rajonale Hartojnë masat që rrjedhin nga raportet e vlerësimit për përmirësimin e performancës së shkollave në rajon. Marrin masat në rastet e veçanta
6. Tekstet shkollore			
Planifikimi dhe përzgjedhja e autorëve dhe botuesve	Qendror	Nivel Shkollë Drejtori i Shkollës mbledh sygjërimet e mësuesve dhe prindërve në lidhje me tekstet shkollore në bazë të eksperiencës së tyre profesionale në fushë dhe i përcjell ato në MASH	Qëndror:MASH Instituti i Kurrikulës Përzgjidhen autorët dhe botuesit nëpërmjet procedurave të prokurimit.

FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
Përgatitja dhe botimi	Qendror	I paaplikueshëm	Qëndror:MASH
Prodhimi dhe shpërndarja	Qëndror/ dekoncentruar	Këshilli i Bashkisë/komunës Mbikëqyr shpërndarjen e teksteve në shkolla. Nivel shkolle Merren tekstet dhe sigurohen që janë shpërndarë tek cdo nxënës.	Qëndror:MASH Mbikëqyr shpërndarjen nga Drejtoria Rajonale Drejtoritë Arsimore Rajonale Shërben si kanal i shpërndarjes
Pasqyrimi i përfituesve	Vendor/ Qendror	Nivel shkolle Mbledh opinione nga nxenes, mësues dhe prind dhe i transmeton ato tek drejtoria rajonale.	Drejtoria Arsimore Rajonale Mbledh opinione dhe mendime mbi tekstet shkollore Qendror MASH Mbledh informacion nga Drejtoritë Rajonale
Vlerësimi	Qendror/ Vendor	Nivel shkolle Mbledh opinione nga nxenes, mësues dhe prind për vlerat e teksteve dhe i transmeton ato tek drejtoria rajonale. Bashki/Komune Paraqet vleresimet e komunitetit, ne vecanti për lendet vendore	Qendrore MASH, rrethi Rishikohen tekstet shkollore sipas vërejtjeve Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Instituti i Kurrikulave Në bazë të analizave dhe vlerësimeve nga komuniteti i paraqet mendimet mbi tekstet tek drejtoritë arsimore.
Financimi	Qendror	I paaplikueshëm	Qëndror:MASH
Subvencion	Qendror/ Vendor	Këshilli i Bashkisë/Komunës Percakton kriteret dhe kontribon financiarisht për të mbështetur familje në nevojë, siguron mbështetje financiare (nga Grantet Bllok) për intitucionet shkollore me literature plotes. Nivel shkolle - Jep inf.në lidhje me nxënësit me nevoja të veçanta për financim	MASH Akordon grante speciale në komunat më të varfëra në vend për marrjen e teksteve shkollore
FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
7. Pajisjet dhe materialet			

Përcaktimi i nevojave	Vendor / Qendror	Nivel shkolle Përcakton nevojat dhe i transmeton ato tek këshillat e bashkive/komunave	I paaplikueshëm
Standardet dhe procedurat	Qendror/ Vendor	I paaplikueshëm	Qëndror: MASH, Përcakton standardet
Sigurimi i pajisjeve dhe materialeve	Vendor/ Njësi dekoncent	Këshilli i bashkisë/komunës siguron pajisjet dhe materialet sipas kërkesave dhe standardeve të paracaktuara	Drejtoritë rajonale Sigurojnë pajisjet laboratorike
Mirëmbajtja dhe riparimet	Vendor	Nivel shkolle Kërkon dhe inspekton te gjitha procedurat per mirembajtjen, riparimet dhe shërbimet e nevojshme per pajisjet. (Autorizon pagesat për ata që kryejnë shërbimet.) Këshilli i komunës/bashkisë Autorizon kryerjen e shërbimeve. Kryen pagesat	Drejtoritë Arsimore rajonale Përcaktojnë standardet
Financimi	Qendror/ Vendor	Këshilli i komunës/bashkisë Percakton dhe amdinistron fondet e mirembajtjes nga granti i buxhetit te shtetit dhe te ardhurat e veta.	I paaplikueshëm
8. Infrastruktura e shkollës			
Përcaktimi i standardeve	Qendror	I paaplikueshëm	MASH Përcakton standardet e ndërtimit
Përgatitja dhe paraqitja e propozimeve	Vendor	Këshillat e bashkive/komunave Kanë përgjegjësinë për përgatitjen dhe paraqitjen tek Pushtetit Vendor Rajonal propozimet për ndërtimet e reja në përputhje me nevojat e komunitetit dhe planifikimet rajonale	
Rishikimi dhe miratimi i propozimeve	Qendror	Niveli i Qeverisjes Rajonale Rishikon dhe aprovon propozimet e paraqitura nga këshillat vendor	MASH Rishikon dhe aprovon propozimet sipas standarteve kombëtare dhe hartave të shkollave dhe i paraqet kërkesat Ministrisë së Financave (MF) Ministria e Financave Rishikon buxhetin dhe paraqet në parlament kërkesën për grante të kushtëzuara të akorduara për

			ndërtimet e reja në njësi vendore të specifikuara Parlamenti Autorizon buxhetin të përcaktojë grant i kushtëzuar
Realizimi i punimeve civile	Vendor	Këshillat e bashkive/komunave Prokurimi dhe inspektimi i punimeve civile për ndërtimin apo rehabilitimin e shkollave dhe pajisjen e tyre.	I paaplikueshëm
Kontrolli i Punimeve civile	Vendor/Qendror	Nivel Shkollë Autorizon kryerjen e kontrollit Këshilli i bashkisë/komunës Kontrollon punimet sipas standarteve të paracaktuara	MASH dhe MPVD Përcaktojnë standarde për punimet e ndërtimit Niveli Rajonal Autorizon punimet sipas standardeve të paracaktuara
Financimi	Qendror	Këshillat e bashkive/komunave Financimi nga grantet e kushtëzuara nga MF . Pushteti vendor <u>mund</u> t'i përdorë ato për financime <u>shtesë</u> të infrastrukturës së shkollës	I paaplikueshëm
FUNKSIONI	ALOKIMI AKTUAL	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT VENDOR	FUNKSIONE DHE PERGJEGJESI TE REJA TE PUSHTETIT QENDROR
9. Mirëmbajtja e Godinës			
Përcaktimi i standardeve	Qendror	I paaplikueshëm	MASH Përcakton standardet për mirëmbajtjen e godinës
Realizimi i shërbimit	Vendor	Këshilli i komunës/bashkisë Kryen të gjitha shërbimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e shkollave dhe konvikteve.	I paaplikueshëm
Mbikqyrja	Vendor	Nivel shkollë Kontrollon shërbimet dhe riparimet. e mirëmbajtjes dhe autorizon pagesat për ata që kryejnë shërbimet.	I paaplikueshëm
Financimi	Vendor	Këshilli i komunës/bashkisë Planifikon dhe përdor fondet e nevojshme (nga grantet bllok dhe burimet e veta) për mirëmbajtjen e shkollave, funksionimin e	I paaplikueshëm

		konvikteve si dhe ben pagesat e nevojshme per operatoret perkates.	
10. Planifikimi			
Ndarja në zona	Qendror/ Vendor	Niveli i Qeverisjes Rajonale Cakton standardet për ndarjen në zona Këshilli i komunës/bashkisë Bën ndarjen në zona sipas standarteve të paracaktuara	I paaplikueshëm
Liçencimi	Qendror	I paaplikueshëm	Qëndror: MASH përcakton kriteret dhe standardet dhe jep licensat për të gjitha institucionet arsimore
Hapja dhe mbyllja e shkollave publike	Qendror/ Vendor	Këshilli i komunës/bashkisë Propozon hapjen e mbylljen e shkollave ose jep mendim kur i kërkohet.	Drejtoria Rajonale Autorizon sygjerimet e këshillave
Hapja dhe mbyllja e shkollave jopublike	Vendor / Qendror	Këshilli i komunës/bashkisë I rekomandon MASH lejet për hapjen e shkollave private.	Drejtoria Rajonale Autorizon hapjet dhe mbylljet e shkollave private/jopublike për arsimin bazë
11. Transporti i nxënësve dhe mësuesve			
Planifikimi	Qendror i dekoncentruar	Këshilli i komunës/bashkisë Planifikon transportin	Drejtoria Arsimore Rajonale Autorizon planin e transportit
Financimi	(Qendror i dekoncentruar)	I paaplikueshëm	Qëndror:MASH Drejtoria Arsimore Rajonale
12. Rregjistrimi i nxënësve			
Përcaktimi i kriterëve për rregjistrim	Qendror	I paaplikueshëm	MASH Përcakton kriteret dhe i paraqet ato tek këshillat e bashkive/komunave
Planifikimi dhe shpërndarja	Vendor/ Qendr.dekonc.	Këshilli i komunës/bashkisë Përcakton kontigjentet për pranimin për çdo shkollë mbi bazë territori.	MASH Përcakton standardet
13. Bursat			
Përcaktimi i standardeve	Qendror/ MPÇS	I paaplikueshëm	MASH MPÇS:
Planifikimi në nivel kombëtar	Qendror/ MPÇS	I paaplikueshëm	Qëndror: MASH MPÇS:
Financimi	Qendror	Nivel shkolle/ Këshilli i komunës/bashkisë Shpërndan bursat tek përfituesit	Qëndror:MASH/MF Transferrimi në Këshillat e bashkive/komunave

Identifikimi dhe alokimi tek studentët dhe nxënësit	Vendor	Këshilli i komunës/bashkisë Percakton nominalisht perfituesit e bursave dhe ben akordimin e fondeve prane familjeve nëpërmjet shkollave ose zyrave vendore	I paaplikueshëm
---	--------	--	-----------------

Kjo shtojcë paraqet hapat fillestarë që duhen marrë për të përcaktuar standardet e shërbimit dhe treguesit e performances për funksionet që do të pilotohen në një faze të parë.

Përkufizimi i standardeve të shërbimit dhe treguesve të performancës

Objektiva	Masat	Institucioni përgjegjës	Afati kohor
A. Përgatitja e e dokumentacionit ligjorë për zbatimin e reformës në arsim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i të gjithë ndryshimeve ligjore të kërkuara për reformën në arsim 2. Parapërgatitja dhe aprovimi i rregullave/amendimeve (ligjet dhe aktet nënligjore) për të zbatuar reformën arsimore (në pilotime) 3. Përzgjedhja e njësive administrative që do të pilotohen 	MASH	TET-NËN 2004 NËN-DHJ 2004 Dhjetor 2004
B. Formulimi dhe aprovimi i standardeve të shërbimit dhe treguesve të performancës për nënfunksonet e decentralizuara	<p>I—Mbi infrastrukturën e shkollës <i>(plani master kombëtar mbi ndërtimin dhe mirëmbajtjen e godinave shkollore)</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përcaktimi (sipas propozimit të MASH, Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe adoptuar nga Këshilli i Ministrave) i një plani master për të vendosur zonat gjeografike prioritare për ndërtime të reja/rikonstruksione apo mbyllje shkollash 2. Përcaktimi (sipas propozimit të MASH, Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe adoptuar nga Këshilli i Ministrave) të standardeve kombëtare minimale të ndërtimit të shkollave të cilat sigurojnë lehtësira dhe siguri publike, hapësira të mjaftueshme, ndriçim të bollshëm, ventilim kushte sanitare të tilla si: instalime të sitemit të ngrohjes, banjo të ndara për vajzat dhe djemtë, instalime elektrike, ujë si dhe siteme për shkarkimin e ujrave të 	MASH	Shkurt 2005 Prill 2005 Maj 2005

	<p>zeza etj.</p> <p>3. Përcaktimi (sipas propozimit të MASH, Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe adoptuar nga Këshilli i Ministrave) të standardeve minimale kombëtare për shërbimet e mirëmbajtjes së godinës së shkollës për të siguruar lehtësira shëndetësore dhe siguri publike (duke përfshirë mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e lehtësirave periferike të tilla si muret e lyera, xhamat e dritareve, çatitë në kushte të mira, sistemin e ngrohjes në rregull, instalimet elektrike, tubacionet e ujrave të bardha e të zeza, etj. ...)</p> <p>II—Nën funksione të tjera të cilat do të decentralizohen gradualisht sipas letrës së politikave <i>(me standarde minimale të paracaktuara për çdo nën-funksion si në pikën I më lart)</i></p>		<p>Qershor 2005</p>
C	<p>I—Infrastruktura të shkollës dhe të tjera nënfunksiione të arsimit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Treguesi fillestar për çdo nënfunksion ➤ Elementët e parë që do të maten: <ul style="list-style-type: none"> i. Infrastruktura ii. Nēnfunksionet e tjera të arsimit 	MASH	<p>Qershor 2005</p> <p>Dhjetor 2005 dhe më pas çdo fund viti</p> <p>çdo fund viti</p>